

Kurti paralajmëron konsultime për presidentin



Faqe 2

Ramush Haradinaj nuk do të jetë më kryetar i AAK-së



Faqe 2

SHBA-ja dhe Evropa po bien dakord se nevojitet një ribalancim i pushtetit



Faqe 6

Kosova në grup me Austrinë, Izraelin dhe Irlandën



Faqe 16

e premte • 13 shkurt 2026

Numri 10272

KOHA

DITORE

www.koha.net



SEANCA E PARË E LEGJISLATURËS SË DHJETË NIS ME VOTIMIN E NJË REZOLUTE TË PROPOZUAR NGA PDK-JA

Pa LDK-në, Kuvendi e miraton Rezolutën për Specialen

Krahas kësaj rezolute, Kuvendi i ka dhënë miratim të enjten edhe zgjatjes buxhetore për marsin e sivjetmë. Pro zgjatjes kanë votuar 99 deputetë, ndërsa ata të Listës Serbe, sikurse në rastin e Rezolutës për Specialen, nuk kanë marrë pjesë në votim. Miratimi u është dhënë edhe përbërjeve të 16 komisioneve parlamentare. Për to kanë votuar 100 deputetë, ndërsa një ka qenë kundër. Prej 16 komisioneve, nëntë do të udhëhiqen nga deputetët e Listës Serbe, tri nga Partia Demokratike, dy nga Lidhja Demokratike dhe komunitetet do t'i kenë në drejtim nga një

Marigona Brahimi

PRISHTINË, 12 SHKURT – Me 90 vota për deputetë të legjislaturës së dhjetë e kanë miratuar të enjten një Rezolutë, nëpërmjet së cilës u ka kërkuar Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë që të ushtrojnë proces gjyqësor të drejtë ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Deputetë të Lidhjes Demokratike (LDK) nuk kanë marrë pjesë në votim, pasi kërkesa e tyre për ta shtuar një pikë në përmbajtjen e Rezolutës nuk është pranuar.

Në prezantimin e përmbajtjes, Përparim Gruda, deputet i Partisë Demokratike (PDK) që edhe e ka propozuar Rezolutën, ka thënë se dokumenti është hartuar nga ekspertë të pavarur.

E pas leximit të përmbajtjes, shefja e Grupit Parlamentar të LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu, ka thënë se ka pasur dakordim gjatë mbledhjes së Kryesisë vetëm që Rezoluta të vihet në rend dite, porse jo edhe për përmbajtjen e saj.

Ajo ka kërkuar që Rezolutës t'i shtohet pika, me të cilën kërkohet zbardhja e vrasjeve të para dhe pas luftës së Kosovës.

“Kjo rezolutë kërkon nga të gjitha institucionet e rendit dhe ligjit të Republikës së Kosovës, si dhe inkurajon mbështetjen ndërkombëtare për intensifikimin e përpjekjeve drejt zbardhjes së plotë të të gjitha



Foto: Driton Paçarada

rasteve të pazbuluara të ndodhura gjatë dhe pas periudhës së luftës në Kosovë, me qëllim që të sigurohet drejtësia për të gjitha viktimat, të zbardhet e vërteta dhe të fuqizohet shteti i së drejtës mbi parimet e paanësisë dhe barazisë para ligjit”, thuhet në pikën që LDK-ja ka kërkuar të përfshihet në Rezolutë.

Pas kësaj, Gruda ka thënë se nuk ka ndryshim në përmbajtje dhe më pas deputetët i kanë dhënë miratimin Rezolutës me 90 vota për, një kundër dhe asnjë abstenim. Në votimin e rezolutës nuk kanë qenë të pranishëm deputetë të Listës Serbe.

Në një nga pikat e Rezolutës, e cila nuk ka peshë detyruese, kërkohet

që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar “në ushtrimin e funksioneve të tyre, të sigurojnë zbatimin me përpikëri të standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, duke respektuar gjithashtu parimet e transparencës, llogarid-

hënies dhe kultivimit të besimit të publikut në drejtësi”.

Gruda ka theksuar se Rezoluta është përpiluar pas shqetësimeve për shkelje të të drejtave të të akuzuarve në Hagë. Nëpërmjet saj u bëhet thirrje Dhomave dhe ZPS-së që të zbatojnë standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të të akuzuarve, “përfshirë edhe detyrimet që burojnë nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

“Kuvendi kërkon nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që, në ushtrimin e funksioneve të tyre, të sigurojnë zbatimin me përpikëri të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, që përmban standardet më të mira ndërkombëtare, lidhur me një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, duke respektuar gjithashtu parimet e transparencës, llogaridhënies dhe kultivimit të besimit të publikut në drejtësi. KËRKON nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që, në ushtrimin e funksioneve të tyre, të sigurojnë zbatimin me përpikëri të standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe të tjerëve, përfshirë edhe detyrimet që burojnë nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

vijon në faqen e dytë

MBROJTJA E KADRI VESELIT PËRMBYLL FJALËN PËRFUNDIMTARE NË SPECIALE, E AJO E REXHEP SELIMIT E NIS

Dixon: Veseli mori pjesë vetëm në tri takime të Shtabit të Përgjithshëm

Ardit Kika

PRISHTINË, 12 SHKURT – Lirimi i Kadri Veselit është kërkuar gjatë fjalës përfundimtare që mbrojtja e tij e ka dhënë të enjten në Gjykatën Speciale në Hagë, ndërsa avokati i Rexhep Selimit tha se me asnjë provë prokuroria nuk ka arritur ta vërtetojë ekzistimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

Rodney Dixon, avokati kryesor i ish-kryeparlamentarit që akuzohet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, tha se Veseli mori pjesë në një pjesë të vogël të mbledhjeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, dhe se në

asnjërin prej këtyre takimeve nuk pati diçka kriminale që do ta vërtetonte akuzën për ndërmarrje të përbashkët kriminale.

“Bëhet fjalë për 3 nga 35 takime të Shtabit të Përgjithshëm, për të cilat ZPS-ja (Zyra e Prokurorit të Specializuar v.j.) ka paraqitur prova në të cilat mbështetet dhe këto janë takime në të cilat nuk ka dalë asgjë kriminale dhe nuk ka pasur as prova që z. Veseli është zëvendësuar në këto takime, as që i ka raportuar dikush apo që ka marrë informata prej secilit nga këto takime dhe nuk mund të hamendësohet kështu”, tha Dixon të enjten.

Veselin, e edhe Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin, Prokuroria i akuzon për ndërmarrje të përbashkët kriminale si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe atyre ua faturon përgjegjësinë për krime që pretendohen të jenë kryer në terren nga pjesëtarë të gueriles.

Avokati Dixon tha se Veseli, i cili ka drejtuar SHIK-un pas lufte, ishte jashtë vendit dhe prokuroria nuk e ka vërtetuar se ai ka mbajtur kontakt apo se ndokush i ka raportuar nga Kosova. Shembull për këtë përmendi dëshmitarin Naser Krasniqi, ish-pjesëtar i Zbulim Kundërzbulimit, që ka qenë trupë e inteligjencës brenda UÇK-së, e të cilën e ka drejtuar Veseli.

Krasniqi, që ka qenë i akuzuar në rastin “Kleçka”, por është liruar nga EULEX-i, ka thënë në Hagë se i raportonte Haxhi Shalës dhe kurrë Veselit. E, avokati Dixon tha se prokuroria është kapur vetëm për një gjë të thënë nga ky dëshmitar e që i konvenon asaj, dhe vetëm atë pjesë e paraqet si të besueshme.

“Është edhe një shembull tjetër i teorisë skizofrenike që ka prokuroria: pra që s’duhet të besoni asgjë në dëshmi, por ky takim është i besueshëm, është i rëndësishëm dhe në këtë rast ai e thotë të vërtetën”, deklaroi Dixon.

vijon në faqen e pestë

Skena e pavarur kulturore një vit vonë me Këshill, rregullorja në draft



Ministritë së Kulturës i janë dashur dy vjet për të hartuar dhe për të nxjerrë në diskutim publik Draftregulloren për funksionimin e Këshillit të Skenës së Pavarur Kulturore. Ky derivat i Ligjit për artin dhe kulturën është dashur të jetë i miratuar qysh para një viti. Ligji është në fuqi prej janarit të vitit 2024. E, vetë Ligji përcakton...

Faqe 11